

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-168/14**

**Prishtinë, 21 shtator 2016**

Në çështjen juridike të:

**I.Sh.**

Fshati Bec

Komuna e Gjakovës

***Pala ankuese***

***kundër***

**M.O.**

Rruga “Juliane Čatić”, nr. 29

Kragujevc

Republika e Serbisë

***Pala përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami kryetar i kolegjit, Anna Bednarek dhe Krassimir Mazgalov anëtarë të kolegjit, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/219/2013, të datës 27 nëntor 2013 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numër KPA19195), pas këshillimit të mbajtur më 21 shtator 2016, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga I.Sh. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/219/2013, të datës 27 nëntor 2013, në lidhje me kërkesën e regjistruar në AKP me numër KPA19195, refuzohet si e pabazuar.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/219/2013, i datës 27 nëntor 2013, sa i përket kërkesës së regjistruar pranë AKP me numrin KPA19195, vërtetohet.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 24 nëntor 2006, M.O. (tani e tutje: pala përgjegjëse në ankesë) duke vepruar në emër të nëns së tij Z.O. , ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (tani e tutje “AKP”), e regjistruar në lëndën KPA19195, duke kërkuar vërtetimin e pronësisë dhe ri-posedimin e ngastrës nr. 1197 e cila gjendet në vendin e quajtur Ravnica/Bec, Komuna e Gjakovës (tani e tutje: prona e kërkuar).Për më tepër, pala përgjegjëse në ankesë kërkon kompensim për shfrytëzimin e pronës së tij pa lejen e tij.
2. Në kërkesë ka theksuar se pronën e kërkuar e ka humbur për shkak të konfliktit të armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë në vitin 1998/99, duke e përmendur 12 qershorin 1999 si datë të humbjes së pronës.
3. Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai i ka dorëzuar AKP-së dokumentet në vijim:
  - Kopjen e ekstraktin të fletës poseduese të lëshuar nga Qendra për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë e Komunës së Gjakovës më 5 tetor 1994, në të cilën figuron se nëna e palës përgjegjëse në ankesë ka poseduar ngastrat e tokës me numër 1218/3, 1194/1 dhe 1197.
  - Aktgjykimin pranues të lëshuar nga Gjykata Komunale e Pejës në lëndën me numër P. 388/93 më 23 korrik 1994, në bazë të së cilit gjykata e fundit ka shpallur kontratën mbi blerjen Nr. 236/63 të lidhur më 17 qershor 1963 në mes të nënës së palës përgjegjëse në

ankesë në cilësinë e shitëses dhe PIK “Ereniku” OUR “ Poljoprivredno dobro” si paraardhës ligjor i PIK “Ereniku”, “PKB Primarna Proizvodnja DOO” në cilësinë e blerësit, të pavlefshme dhe PIK “Ereniku” OUR “ Poljoprivredno dobro” është obliguar që t’ia dorëzojë në posedim të qetë dhe të lirë nënës së palës përgjegjëse në ankesë ngastrat kadastrale në vijim: 90/30, 90/60, 13/1, 13/2, 306/13 dhe 306/47.

- Kopjen e certifikatës së lindjes së palës përgjegjëse në ankesë Nr. 200-3852/04-VII të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil të Komunës së Gjakovës më 6 korrik 2004.
  - Kopjen e autorizimit nga Z.O. tek djali i saj për ta përfaqësuar atë në procedurën pranë Agjencisë Kosovare të Pronës. Nënshkrimi i Z.O. është vërtetuar nga Gjykata Komunale në Kragujevc më 6 shtator 2007 (Ov.10929/07).
4. Njoftimi fillestar i pronës së kërkuar është bërë më 3 dhjetor 2007, duke gjetur se prona nuk ishte duke u shfrytëzuar.
  5. Pasi që askush nuk kishte paraqitur përgjigje brenda afatit, kërkesa është konsideruar si jokontestuese. Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së ka verifikuar pozitivisht fletën poseduese nr. 206 në të cilën prona e kërkuar figuron në emër të nënës së palës përgjegjëse, si dhe certifikatën e lindjes së palës përgjegjëse në ankesë.
  6. Më 22 shkurt 2008, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (tani e tutje: KKPK) me vendimin e tij Nr. KPCC/D/A/8/2008 ka pranuar kërkesën duke vërtetuar të drejtat pronësore të nënës së palës përgjegjëse në ankesë mbi pronën e kërkuar.
  7. Me vendimin Nr. KPCC/RES/19/2010 të datës 12 maj 2010, Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së ka njoftuar Komisionin për Kërkesa Pronësore të Kosovës se kërkesa nuk është procesuar në mënyrë të duhur, përkatësisht, prona e kërkuar nuk është identifikuar fizikisht dhe njoftimi i kërkesës nuk është bërë në mënyrë të duhur, prandaj lënda i është kthyer prapa Sekretariat Ekzekutiv për ta bërë njoftimin në mënyrë të duhur.

8. Rrjedhimisht, kërkesa është ri-njoftuar më 3 nëntor 2010. Ngastra e tokës është gjetur të jetë tokë e pa kultivuar, e zënë nga K.Sh. , i cili ishte i pranishëm në pronë dhe ka pretenduar të drejta ligjore mbi pronën e kërkuar dhe ka nënshkruar njoftimin e pjesëmarrjes.
9. Më 11 qershor 2013, i afërmi i K.Sh. t, I.Sh. (tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur përgjigje në kërkesë. Pala ankuese pretendon se nga viti 1930 gjyshi i tij Q.Sh. ka qenë pronar i pronës së kërkuar, mirëpo në vitin 1962 “Kombinati Ereniku” ia ka marrë tokën familjes së tij me forcë dhe pa kompensim. Në ndërkohë, ai dhe familja e tij janë detyruar ta marrin pronën me qira pasi që nuk ka pasur mënyrë tjetër për ta fituar posedimin e saj. Familja Sh., sipas palës ankuese e ka shfrytëzuar pronën e kërkuar derisa i është dhënë familjes Oradović.
10. Në mbështetje të pretendimeve të tij, pala ankuese ka dorëzuar kopjen e certifikatës “historikun” nr. 952-06-30/13 të lëshuar nga Departamenti i Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronës i Komunës së Gjakovës më 6 qershor 2013, duke sqaruar se më 1994 në bazë të aktgjykimit Nr. 388/93 dhe marrëveshjes gjyqësore Nr. 15/94, nëna e palës përgjegjëse në ankesë ka hyrë në posedim të ngastrës së tokës nr. 1197.
11. Më 27 nëntor 2013, KKPK-ja me vendimin e tij Nr. KPCC/D/A/219/2013 ka pranuar kërkesën dhe ka gjetur se nëna e palës përgjegjëse në ankesë ka qenë pronare e pronës së kërkuar dhe ka shpallur se ajo ka të drejtën e posedimit. KKPK-ja ka konsideruar se palët ankuese kanë dështuar që të paraqesin dokumente që kanë të bëjnë me pronën e kërkuar në mbështetje të pretendimeve të tyre se familja e tyre e ka shfrytëzuar ngastrën dhe se ajo i ishte marrë nga NSH “Ereniku”.
12. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 24 mars 2014. K.Sh. e ka pranuar vendimin më 25 prill 2014, ndërsa më 7 maj 2014 ka paraqitur ankesë kundër vendimit pranë Kolegjit për Ankesa të AKP-së të Gjykatës Supreme.
13. Ankesa i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 2 shtator 2014. Ai ka paraqitur përgjigje ndaj ankesës.

### **Pretendimet e palëve**

14. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës ta hedhë poshtë kërkesën e palës përgjegjëse në ankesë për shkak të mungesës së juridiksionit ose ta ndryshojë vendimin e KKPK-së dhe ta refuzojë kërkesën si të pabazuar. Në ankesë pala ankuese tregon se vendimi i KKPK-së mbështetet në një gabim thelbësor dhe në shkelej serioze të ligjit material dhe të procedurës, si dhe në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
15. Sipas mendimit të palës ankuese të gjitha faktet e paraqitura nuk janë vlerësuar në mënyrë të barabartë, sepse gjatë procedurës ka deklaruar se prona e kërkuar ishte në shfrytëzim të paraardhësit të tij që nga viti 1975. Përveç kësaj, kishte kontratën mbi shfrytëzimin e pronës së njëjtë. Pala përgjegjëse në ankesë ka përmendur se familja O. kurrë nuk e kanë pasur në posedim pronën e kërkuar. Për këtë arsye pala përgjegjëse në ankesë kurrë nuk e ka humbur posedimin për shkak të konfliktit në Kosovë, por për shkak se asnjëherë nuk e ka poseduar pronën e kërkuar. Pala ankuese nuk ka bashkangjitur në ankesë asnjë dokument.
16. Pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur përgjigje në ankesë në të cilën mohon pretendimet e palës ankuese, dhe ka bashkangjitur dokumentet në vijim:
- Kopjen e vendimit të lëshuar nga Gjykata Komunale e Gjakovës më 14 prill 1998, në bazë të së cilit ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e K.Sh. t e paraqitur kundër Z.O. për ri-posedimin e ngastrës së tokës nr. 1194/1.
  - Kopjen e procesverbalit të marrë gjatë seancës së mbajtur në Gjykatën Komunale të Gjakovës më 4 tetor 1994 në lëndën I.nr. 15/94 gjatë së cilës palët: debitori “PKB Primarna Proizvodnja DOO” dhe Z,O. kanë bërë marrëveshje dhe kanë vendosur që ngastrat e tokës nr. 306/13 dhe 306/47 që janë përmendur në aktgjykimin e lëshuar në lëndën P.nr.388/93 më 26 qershor 1994 të këmbehen me ngastrën e tokës nr. 1194/1, 1197 dhe një pjesë të ngastrës së tokës nr. 1218/1, të gjitha të shënuara në emër të debitorit dhe të dorëzohen në posedim dhe pronësi të kreditorit (nënës së palës përgjegjëse në ankesë).
  - Kopjen e procesverbalit të marrë gjatë seancës së mbajtur në Gjykatën Komunale të Gjakovës më 15 maj 1997 në lidhje me ekzekutimin e aktvendimit për ekzekutim I 436/97 në lëndën e kreditorit (nënës së palës përgjegjëse në ankesë) kundër debitorit “PKB Primarna Proizvodnja DOO”.

## Arsyetimi ligjor

17. Gjykata Supreme pas shqyrtimit dhe vlerësimit të parashtrësive të palëve, të provave të mbledhura në shkresat e lëndës, të vendimit të apeluar dhe të pretendimeve të palës ankuese, konsideron se ankesa është e pabazuar.
18. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë të gjykojë kërkesat që kanë të bëjnë me konfliktin duke përfshirë rrethanat që lidhen drejtpërdrejt ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Prandaj, pala pretenduese jo vetëm që duhet ta sigurojë të drejtën e pronësisë mbi një pronë të paluajtshëm private, por edhe duhet të tregojë se ai apo ajo tani nuk ka mundësi ta ushtrojë atë të drejtë pronësore për arsye që lidhen drejtpërdrejt ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur.
19. Pala përgjegjëse në ankesë ka deklaruar se e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar më 12 qershor 1999 si rezultat i rrethanave të vitit 1998/1999 në Kosovë.
20. Në anën tjetër, pala ankuese pretendon se ai dhe familja e tij kishte në posedim pronën e kërkuar dhe se KKPK-ja nuk ka juridiksion për të vendosur mbi kërkesën pasi pala përgjegjëse në ankesë nuk e ka poseduar pronën para konfliktit.
21. Provat e paraqitura para KKPK-së tregojnë se nëna e palës përgjegjëse në ankesë e ka fituar të drejtën pronësore dhe posedimin e pronës së kërkuar në bazë të marrëveshjes gjyqësore I.nr. 15/94 dhe të procedurës së ekzekutimit. Prona e kërkuar ishte për më tepër e regjistruar në emrin e Z.O.
22. Duhet të shënohet gjithashtu se provat e dorëzuara nga pala përgjegjëse në ankesë nuk lidhen me pronën e kërkuar. Si pasojë, nuk është vërtetuar rrethana që pala ankuese ishte kinse pronari dhe se kishte në posedim pronën e kërkuar gjatë konfliktit.
23. Gjykata Supreme konsideron se kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me konfliktin e armatosur, për arsye se pala përgjegjëse në ankesë ka konfirmuar se humbja e pronës së kërkuar ka ngjarë për shkak të konfliktit të armatosur, kurse pala ankuese nuk e ka vërtetuar të kundërtën. Përveç kësaj, pala e njëjtë përgjegjëse në ankesë ka pranuar se ai dhe familja e tij nuk e kanë poseduar pronën e kërkuar, por ngastrat e tjera të tokës.

24. Sa i përket kërkesës së palës përgjegjëse në ankesë për kompensim për shfrytëzimin e pronës pa pëlqimin e tij, sipas ligjit nr. 03/L-079 as Komisioni e as Kolegji i Apelit i AKP-së i Gjykatës Supreme nuk kanë juridiksion mbi një kërkesë të tillë.
25. Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë, të bazuar në procedurë të plotë dhe të saktë. Rrjedhimisht nuk është bërë asnjë shkelje e ligjit material si dhe nuk është bërë vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike. Gjykata Supreme gjen se ankesa është e pabazuar dhe se vendimi i apeluar duhet të konfirmohet.
26. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në bazë të nenit 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë juridike**

27. Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Beshir Islami , kryetar i kolegjit**

**Anna Bednarek, gjyqtare e EULEX-it**

**Krassimir Mazgalov , gjyqtar i EULEX-it**

**Sandra Gudaityte, referente e EULEX-it**